

VENDIM
Nr. 619, datë 22.10.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I ‘BANESËS SË TOPTANASVE’
MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rijetësimi i ‘Banesës së Toptanasve’ Muzeu Etnografik i Tiranës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë banimi”, me shumën e përgjithshme prej 252 314 551 (dyqind e pesëdhjetë e dy milionë e treqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 252 314 551 (dyqind e pesëdhjetë e dy milionë e treqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LLOGARITJET PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI
“RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I ‘BANESËS SË TOPTANASVE’ MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS”

Nr.	EMËR Atësi MBIEMËR	Z. K.	NR. pas.	SIP. përgj. truall (m²)	SIP. prekur truall (m²)	Çmimi për truall (lekë/m²)	VLERA truall i prekur (lekë)	Sip. e gjurmës së objektit sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. Ndërtimi e objektit sipas kartelës (m²)	Sip. prekur objekt (m²)		ÇMIMI për objekt banimi (lekë/m²)	VLERA sip. prekur objekt, shërbimi, me situacion (lekë)	VLERA sip. prekur objekt banimi (lekë)	VLERA e përgj. truall + objekt (lekë)	KONFIRMIM ASHK TIRANË	SHËNIM E
										Sip. shërbimi (m²)	Sip. banimi (m²)						
1	BP. Këllezi, Kosova, Zajmi, Hoxholli, Permeti, Podgorica, Kazazi, Pashollari, Pirgu, Llapaj, Cara, Skenderi, Stermasi, VI&VI sh.p.k.	8150	1/65	1569	1569	66969	105074361	848.00	848.00	0.00	848.00	173632.30	0.00	147240190.4	252314551	Konfirmohet me shkresat nr. prot.2622/1, datë 27.4.2020 dhe 2482/5, datë 17.8.2021, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Veri	Në seksionin “D” të kartelës së pasurisë ka shënimin “Në bazë të kontratës së nr. 683/204, datë 30.3.2009, notere Alma Poshi, kjo pasuri është me qira për 10 vjet.
VLERA TOTALE PARAPRAKE					1569										252314551		

SHËNIM.

1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresën nr. prot. 2622/1, datë 27.4.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 2482/5, datë 17.8.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.